

VENDIM
Nr.597, datë 24.8.2011

**PËR AKORDIM FONDI FINANCIAR SHITESË INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË
QARKUT TË KORÇËS, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË
VIKTIMËS LILJANA ALBERT ARAPI, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
CEREMONISË MORTORE TË VIKTIMËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2011, institucionit të prefektit të qarkut të Korçës, t’i akordohet fondi financiar shtesë prej 300 000 (treqind mijë) lekësh, për dhënie ndihme financiare familjes së viktimës Liljana Albert Arapi, për mbulimin e shpenzimeve të ceremonisë mortore të viktimës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm dhe prefekti i qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha